



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0098**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi-Brajshori-Anëtar të Panelit Shqyrtues, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (GOE) Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit: 632-25-5966-5-2-1, me 24/03/2026, mori:

### **Vendim**

1. Aprovohet, si pjesërishtë e bazuar ankesa e OE Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. me nr. 2026/0098, e datës 16/02/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit: 632-25-5966-5-2-1.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftim mbi vendimin e AK-se lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit 632-25-5966-5-2-1
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K.

### **Arsyetim**

#### ***-Faktet dhe rrethanat procedurale -***

Me 02/07/2025, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimi për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit: 632-25-5966-5-2-1.

Me 05/02/2026, OE Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si te pabazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 16/02/2026, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. me nr. 0098/2026 lidhur me aktivitetin “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit: 632-25-5966-5-2-1.

### ***-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-***

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

### **Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. janë parashtruar si në vijim:**

#### Pretendimi 1

“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 a) Një (1) Menaxher te Projektit - Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) ne Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Konstruktiv me 10 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Deshmia a) Të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe për menaxherin e projektit duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. Vlerësimi i kandidatit të propozuar, K.K. Ka diplomuar në vitin 2003. Sipas CV-së, përvoja e tij është: o 2003-2018: Punë në Project Bureau Architecture. Faqe 5 nga 15 Megjithatë, referenca zyrtare nga kjo kompani konfirmon vetëm periudhën 2008-2018, duke krijuar një mospërputhje serioze midis CV-së dhe referencës. Një referencë shtesë është dorëzuar nga kompania MBB Construction, por përvoja e përshkruar aty nuk figuron në CV-në e kandidatit, duke ngritur dyshime për saktësinë dhe vërtetësinë e dokumentacionit të dorëzuar.”

#### Pretendimi 2

“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 ç) Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) ne Inxhinierinë e Ndërtimit, drejtimi Hidroteknikë, me 3 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Deshmia ç) Të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe për menaxherin e projektit duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. Operatori ekonomik i shpallur fitues ka paraqitur një kandidat, B.S., e cila: Ka diplomuar më datë 20.07.2020; Ne CV e dorëzuar mbi përvojë ka paraqitur pervojën në periudhat: o 02.08.2018- 29.12.2018 (para diplomimit-nuk llogaritet) o 01.05.2019-28.10.2020 (nga kjo periudhë, vetëm 3 muaj pas diplomimit janë të vlefshëm) o 10.01.2023-17.08.2025 (2 vite e 7 muaj përvojë pas diplomimit). Total përvojë pas diplomimit: 2 vite e 10 muaj. Prandaj, kandidati i propozuar nuk përmbush kushtin e detyrueshëm për 3 vite të plota përvojë pune pas diplomimit, siç kërkohet qartë në dokumentet e tenderit.”

#### Pretendimi 3

“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 e) Një (1) Inxhinier i nivelit Master (ose me sistemin e vjetër inxh. i diplomuar) Inxhinierinë Mekanike, drejtimi Termoenegjetikë dhe Termoteknikë, me 5 vite përvojë pune profesionale pas diplomimit. Deshmia e) Të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi veprën duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe për menaxherin e projektit duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin. Operatori ekonomik i shpallur fitues ka dorëzuar diplomë për inxhinier me drejtim: “Teknika e ngrohjes dhe termoenegjetikë”, që nuk përputhet me drejtimin e kërkuar në dosjen e tenderit, as për nga formulimi i specifikuar dhe as për nga emërtimi formal i kërkuar nga AK.”

#### Pretendimi 4

“Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Faqe 12 nga 15 Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit Pasjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT. Bazuar në Aneksin 7 të dosjes së tenderit, ku është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë posedimin ose sigurimin e 700 m<sup>2</sup> skelë, konstatojmë se operatori fitues ka dorëzuar DUD për vetëm 210 pjesë të ndara (këmbë 40 cm, diagonale, el-profila, etj.), gjë që nuk mjafton për të ndërtuar një sipërfaqe prej 700 m<sup>2</sup> skelë funksionale. Pas rivlersimit vërehet që OE nuk ka dorëzuar dudu ku shifen qart mirpo vetem me një leter te sqarimet e ka ckeur ndarjet e skeleve në rama dhe nuk e ka detajuar se një ram sa m<sup>2</sup> është dhe nuk ka bashkangjitur dudat ku shihet qart sasia.”

#### Pretendimi 5

“Të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve - IPMA. Kompania jonë ka dorëzuar dokumentacionin për z. D.K., i cili posedon certifikatën për menaxhimin e projekteve. Qëllimi i certifikatës është identik me atë të IPMA-s. Edhe pse certifikata jonë nuk ka emrin IPMA, ajo dëshmon aftësinë e menaxhimit të projekteve. Nuk ka dallime reale në përmbajtje. Është për tu habitur se si AK (Komisioni i Vlerësimit) e ka kontestuar një certifikatë me arsyetimin se nuk posedon datën e skadimit dhe, pasi që nuk posedon datë, nuk i përmbush kërkesat e DT. Të nderuar, certifikatat dhe licencat kanë dallime, dhe në këtë rast është kërkuar certifikatë, dhe jo çdo certifikatë posedon datë të skadimit. Refuzimi i ofertës sonë me arsyetimin se nuk kemi certifikatën IPMA është i pabazuar.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 16/02/2026 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0098/2026, ndërsa me datë 26/02/2026 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 0098/2025, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

#### ***- Administrimi dhe vlerësimi i provave -***

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtrësit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Triangle SH.P.K. & Intact SH.P.K. eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0098 ka vlerësuar si në vijim:

#### Pretendimi 1

Eksperti shqyrtues sqaron që sipas kërkesës së stafit profesional, ku ndër të tjera është kërkuar edhe a). një menaxher i projektit, inxhinier i ndërtimtarisë me drejtimin konstruktiv dhe 10 vite përvojë pune, OE i rekomanduar sipas listës së stafit të dorëzuar në ofertë ka caktuar z. K.K. për të cilin janë dorëzuar diploma e noterizuar, CV, certifikata dhe disa referenca si dëshmi për përvojën e punës.

Sipas dosjes së tenderit dëshmitë e kërkuar sa i përket menaxherit të projektit janë përfshirë CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rastet e lidhjes së kontratës mbi vepër të specifikohet titulli i projektit si dhe vendimi për projekt menaxherin. OE ankues ka ngritur pretendim se në lidhje me menaxherin e projektit nuk e ka dëshmuar në mënyrë të saktë dhe të verifikueshme përvojën ku në CV e ka cekur se ka qenë i angazhuar me punë tek Project Bureau Arkitektura, ndërsa në referencë është cekur se i njëjti ka qenë i angazhuar në periudhën 2008-2018.

Në lidhje me këtë pretendim të ngritur eksperti shqyrtues sipas mendimit të tij sqaron që referenca e lartpërmendur është dorëzuar me ofertën e OE i rekomanduar dhe sipas kësaj reference të lëshuar në vitin 2019 deklarohet se menaxheri i projektit ka punuar në ndërmarrjen përkatëse që nga viti 2008-2018 sipas të cilës përmbushet periudha 10 vjeçare e përvojës së punës e kërkuar për inxhinierin e ndërtimtarisë i cili është caktuar menaxher i projektit për këtë aktivitetit. Sa i përket pjesës që në CV është paraqitur viti 2003 në vend të vitit 2008 e cila është në mos përputhje me referencën, eksperti pasqyron që kjo gjë sipas mendimit tonë përbënë devijim të vogël sipas nenit 59.4 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), pra edhe pa vitet e parapara në CV kushti i përvojës së punës për inxhinierin është përmbushur dhe se fakti se në CV janë cekur edhe disa vite më shumë nuk përbënë ndonjë ndryshim thelbësor i cili nuk ka ndikim në vlerësimin e ofertës së OE i rekomanduar. Po ashtu, në ofertë janë dorëzuar edhe disa referenca të tjera të cilat e paraqesin përvojën e punës së menaxherit edhe në vitet më pas, këto referenca janë pjesë e ofertës edhe pse të njëjtat nuk janë përfshirë edhe në CV, megjithatë kemi sqaruar që edhe pa këto referenca të tjera përvoja e menaxherit të projektit është dëshmuar me referencën e lëshuar nga B.P. "Arkitektura". Nga sqarimet e bërë më sipër vlerësojmë që ky pretendimi i ngritur nga ana e OE ankues është i pabazuar.

#### Pretendimi 2

Si kërkesë tjetër e dosjes së tenderit ka qenë që operatorët ofertues të ofrojnë dëshmi edhe për inxhinier të ndërtimit, drejtimi hidroteknikë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Eksperti shqyrtues me ngritjen e këtij pretendimi ka analizuar dokumentet relevante për inxhinierin e kërkuar dhe tutje sqaron që për këtë pozitë sipas listës së stafit është znj. B.S. ku sipas ofertës së pari është ofruar diploma Bachelor e cila sipas kërkesave të dosjes nuk përkon me inxhinierin e diplomuar të kërkuar sipas DT-së, më vonë nga sistemi e-prokurimi shihet se është dorëzuar diploma Master për inxhinieren B.S. sipas të cilës sqarohet se inxhinieria ka diplomuar në vitin 2020 në programin studimor Hidroteknikë e që është sipas kërkesave të dosjes së tenderit dhe konsiderojmë që ky sqarim është në përputhje me nenin 72 të LPP-së, pasi që ekzistenca e këtij dokumenti para afatit të fundit të dorëzimit të ofertave mund të vërtetohet në mënyrë objektive. Po ashtu me sqarime shtesë është dorëzuar edhe një referencë nga kompania N.N. Blitern përmes të cilës citohet se inxhinieria B.S. ka qenë e angazhuar si inxhinier e ndërtimtarisë,

drejtimi hidroteknikë nga data 01/01/2023 e deri më tani. Sipas CV-së me ofertë eksperti pasqyron që ka dallim mes pozitës së punës ku sipas CV-së është cekur se B.S. është eksperte e sigurisë dhe shëndetit në punë, krahasuar me referencën e dorëzuar me sqarime shtesë sipas të cilës thuhet se e njëjta është në pozitën e inxhinierës së ndërtimtarisë. Edhe pse kjo referencë përmbanë një datë të lëshimit sipas mendimit të ekspertit shqyrtues për shkak edhe të mos përputhjes me CV-në e dorëzuar me ofertë, konsiderojmë që ekzistenca e këtij dokumenti nuk mund të vërtetohet në mënyrë objektive që ka ekzistuar sipas afatit të përcaktuar në nenin 72 të LPP-së. Theksojmë që sipas e-prokurimi, një CV tjetër është dorëzuar më herët me sqarime shtesë (muaji Gusht 2025) për B.S. përmes të cilës është ndryshuar pozita në ndërmarrjen e lartpërmendur nga eksperte për shëndet dhe siguri në punë duke i shtuar edhe titullin e pozitës inxhinierë e ndërtimtarisë. Ky ndryshim sipas ekspertit shqyrtues nuk është në përputhje me nenin 59 të LPP-së, përmes të cilit nuk lejohen ndryshimet materiale të ofertës fillestare.

Kështu që sa i përket pjesës së përvojës së punës për inxhinierën në fjalë, nga muaji Shtator 2020 sipas CV-së dhe dëshmime të tjera të dorëzuar me ofertë shihet se e njëjta nuk e ka përvojën e kërkuar 3 vite pas diplomimit siç është kërkuar në dosjen e tenderit. Duhet sqaruar që për B.S. është dorëzuar edhe certifikata e kërkuar për menaxhimin e projekteve-IPMA ku është kërkuar që të paktën njëri prej inxhinierëve të kërkuar të jenë të certifikuar me këtë certifikatë, por sipas mendimit të ekspertit përderisa inxhinieria e lartpërmendur nuk i ka përmbushur kërkesat bazë të përvojës së punës sipas FDT-së, vlerësojmë që në një situatë të tillë nuk mund të merret e përmbushur as kërkesa e FDT-së për certifikatën IPMA. Konsiderojmë që ky pretendim i ngritur nga operatori ankues është i bazuar.

### Pretendimi 3

Sqarojmë që sipas dosjes së tenderit është kërkuar dorëzimi i dëshmime përkatëse për një inxhinier të mekanikës, drejtimi Termoenergjetikë dhe Termoteknikë. OE i rekomanduar për këtë kërkesë ka dorëzuar dëshmitë për inxhinierin G.K. sipas listës së stafit profesional të dorëzuar me ofertë.

Pas ngritjes së pretendimit nga ana e OE ankues se i njëjti ka dorëzuar diplomë me drejtimin Teknika e ngrohjes dhe termoenergjetika që nuk përputhet me kërkesën e dosjes për drejtimin termoenergjetikë dhe termoteknikë, eksperti ka analizuar diplomën e dorëzuar për inxhinierin G.K. dhe sqarojmë që me ofertë për këtë inxhinier është dorëzuar diploma e nivelit Master, e fakultetit të inxhinierisë mekanike të Universitetit të Prishtinës dhe sipas kësaj diplome G.K. ka përfunduar studimet përkatëse në departamentin e Termoteknikës dhe Termoenergjetikës, drejtimi teknika e ngrohjes dhe termoenergjetika ku sipas mendimit të ekspertit shqyrtues kjo diplomë është në përputhje me kërkesat e dosjes të kërkuara nga AK. Theksojmë që Universiteti i Prishtinës është një nga institucionet më të mëdha të arsimit në vend dhe ky ndryshim i vogël në emërtimin/termin e përdorur në drejtimin e fakultetit nuk përbënë asnjë dallim nga drejtimi i kërkuar për arsye se konsiderojmë që termi teknikë e ngrohjes dhe termoteknikë janë vetëm emërtime të ndryshme por te cilat kanë të bëjnë me lëminë e njëjtë. Përndryshe sqarojmë që emërtimet e drejtimeve varen nga institucionet e ndryshme të arsimit por konsiderojmë që edhe kur vendosen kërkesat nga ana e AK-së, të njëjtit duhet t'i referohen emërtimeve të përgjithshme të cilat përdoren veçanarisht nga institucionet më të mëdha publike arsimore, andaj vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i pabazuar.

### Pretendimi 4



Eksperti shqyrtues sqaron që në lidhje me kërkesën e Aneksi 7-Lista e pajisjeve, pozicioni 14 ku janë kërkuar posedimi i skeleve me sasi 700 m<sup>2</sup>, AK ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me këtë pozicion. Ku me datë 23/01/2026 për këtë pozicion është dorëzuar një letër sqaruese për dokumentet e dorëzuara si dhe një skemë e mbulueshmërisë së skeleve. Ky sqarim i kërkuar është vlerësuar dhe pranuar nga ana e AK-së, ku sipas tyre sqarimet e dorëzuara dhe dokumentet shtesë e plotësojnë sasinë e kërkuar prej më shumë se 700 m<sup>2</sup> skele. Sqarojmë që sipas nenit 52.7 të Ligjit për Prokurimin Publik, është në diskrecion të AK-së që të kryej një kontrollë efektiv të informatave dhe dokumentacionit të tenderit, edhe në këtë pikë konsiderojmë që verifikimi i përmbushjes së këtij kriteri nga operatori i rekomanduar mbetet në diskrecionin e AK-së.

#### Pretendimi 5

Në njoftimin mbi vendimin e AK-së, si arsye e eliminimit të operatorit ankues është që të njëjtit nuk kanë prezantuar certifikatën për menaxhimin e projekteve IPMA, me validitet siç është kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë.

Sqarojmë që sipas kërkesave të dosjes së tenderit, ndër të tjera është kërkuar që operatorët ofertues të ofrojnë dëshmi se të paktën një nga inxhinierët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve-IPMA dhe si dëshmi ku duhet të ofrohen certifikatat përkatëse, të njëjtat janë kërkuar të jenë valide. Eksperti ka analizuar ofertën e OE ankues dhe sqaron që për këtë kërkesë është dorëzuar certifikatë për z. D.K. përmes të cilës sqarohet se i lartpërmenduri ishte pjesëmarrës 15 ditë në trajnim mbi menaxhimin e projektit.

Në lidhje me këtë çështje eksperti shqyrtues sqaron që ka një dallim mes kërkesës së DT-së dhe certifikatës së dorëzuar nga OE ankues. Edhe nëse e lëm anash faktin se kjo certifikatë jo domosdoshmërisht do të duhej të lëshohej nga IPMA apo ndonjë trupë tjetër e ngjashme, dallimi mes kriterit i certifikuar për menaxhim të projektit dhe të kësaj certifikatë në menaxhimin e projektit ekziston. Përderisa për pjesëmarrjen në çdo trajnim lëshohet një certifikatë e pjesëmarrjes e cila certifikatë e fituar nuk ka afat të skadencës dhe mund të përdoret si pasurim i CV-së gjatë tërë kohës, për dallim të jesh i certifikuar formalisht në një lëmi të caktuar, ku për të poseduar një certifikatë duhesh t'i nënshtrohesh një procesi të vlerësimit zyrtar përmes testimit të njohurive dhe përvojës dhe të njëjtat duhet të përfundohen me sukses për të pasur mundësi certifikimin në fushën përkatëse dhe gjithashtu sqarojmë që ky certifikim formal zakonisht bëhet për kohë të caktuar dhe në shumicën e rasteve kërkohet rinovimi i saj, pra këto certifikata zakonisht kanë një validitet se deri kur janë të vlefshme.

Sipas mendimit të ekspertit shqyrtues certifikata e ofruar nga ana e operatorit ankues për ndjekje të trajnimit në menaxhimin e projekteve nuk e përmbushë kriterin e dosjes për certifikim formal ku është kërkuar inxhinier të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve-IPMA, me validitet. Pasqyrojmë që Ligji për Prokurimin Publik, neni 108/A, pika 3.1 mundëson operatorëve që në rastin kur nuk pajtohen me kërkesat e dosjes së tenderit të kenë mundësi që këto kërkesa të DT-së ti atakojnë përmes kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës, përderisa një operator pranon kërkesat e përcaktuara në dosje duke mos i atakuar ato konsiderojmë që është pajtuar dhe që dëshmitë duhet ti dorëzojnë në përputhje me këto kërkesa. Nga ç'farë u sqarua më lartë, vlerësojmë që ky pretendim i ngritur nga ana e OE ankues është i pabazuar.

**- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –**

Paneli konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Paneli Shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit. Prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, ndonjë raport dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit, dhe konstaton se pretendimet ankimore me nr rendor 1,3,4,5. Paneli Shqyrtuesi mbështet konstatimin në raportin e ekspertit shqyrtues. Ndërsa lidhur me pretendimin 2, ku AK në NJK dhe DT tek kërkesat mbi mundësit teknike/ apo profesionale sa i përket inxhinjerit B.S, PSH analizoj CV-në e inxhinjerit dhe sipas CV Studimet në sistemin bachelor në drejtimin teknik i ka të perfunduar në vitin 2017 si dhe konstaton se në ofertë është dorëzuar referenca mbi përvojën e punës me SUISSE COMPANY, (ku sipas referencës kjo inxhinjere ka qenë e punësuar prej datës 15.12.2019 deri 30.09.2021, dhe NN BLITERM, diplomimi i saj si master i shkencave teknike të ndërtimore me programet studimore të hidroteknikës, ku studimet i ka mbaruar me datën 30 korrik 2020, ku përvoja e saj nga data e diplomimit (16. Shtator 2020) konsiderohet në periudhë prej 1 vite e 14 ditë), ndërsa tek NN BLITERM, sikurse ekspertja në konstatimin e saj e cila ka konstatuar se sipas CV së së dorëzuar sa i përket pjesës që në CV është paraqitur viti 2023 në vend të 2008 e cila është në mos përputhje me referencën ku për ekspertin përbën devijime të vogla siç është në nenin 59.4 të LPP-se, ku pra edhe pa vitet e parapara në CV kushti përvojës së punës për inxhinjer është përmbushur, ndërsa në anën tjetër sipas ankuesit sipas përvojës : 02.08.2018- 29.12.2018 (para diplomimit-nuk llogaritet) o 01.05.2019-28.10.2020 (nga kjo periudhë, vetëm 3 muaj pas diplomimit janë të vlefshëm) o 10.01.2023-17.08.2025 totalin e përvojës pas diplomimit e ka prej 02 vite e 10 muaj, dhe se PSH duke i analizuar edhe përgjigjet në raportin e ekspertizës konsideron që të dy referencat e ofruar e përmbushin përvojën e kërkuar prej 03 vite pas diplomimit, ndërsa sa i përket çertifikatës së kërkuar sipas NJK dhe DT f.) Të paktën një nga inxhinjerët e kërkuar të jetë i certifikuar për menaxhimin e projekteve Lista e kualifikimeve shkollorë dhe profesionale të personelit tuaj profesional dhe teknik të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani, si dhe Certifikatë valide (kopje) për 1(një) punëtorë të trajnuar SSHP(siguri dhe shëndet në punë, si dhe për menaxherin e projektit duhet të ofrohet dëshmi dhe vendimi për projekt menaxherin IPMA) si dhe nga gjithë të gjeturat në këtë procedurë përfshirë edhe përgjigjet në sqarimet e kërkuara nga AK-ja konstatohet që inxhinjerja e caktuar B.S përveç që ka përmbushur përvojën prej 03 vite sipas përshkrimit të lartëcituar, konsiderohet që ka përmbushur edhe këtë kërkesë. Ndërsa lidhur me eliminimin e OE ankues nga AK-ja në mos përmbushje të kërkesave të percaktuara në NK dhe DT - nga AK-ja lidhur me çertifikatën e kërkuar INPA, konstatohet se OE ankues ka dështuar të argumentojë posedimin e certifikatës IPMA. Ky fakt nga OE ankues mbetet i paprovuar si në fazën e kërkesës për rishqyrtimit pranë AK-së, ashtu edhe në procedurën

ankimore në OSHP, duke u vërtetuar edhe nga gjetjet e raportit të ekspertit shqyrtues pasi u vërtetua se operatori nuk posedon certifikatën IPMA, kështu duke dështuar në përmbushen e kërkesave të përcaktuara të NJK-së dhe DT-së sikurse parashihen në nenet 51, 52, 56, dhe 60 të LPP-së , andaj edhe nëse lënda kthehet në rivlerësim, epilogu mbetet prap i njëjtë.

Rrjedhimisht, Paneli Shqyrtues nga gjithë të gjeturat në këtë procedurë dhe në mbështetje të nenin 1 dhe 7 të LPP-se ka vendosur ka lë në fuqi B58 ‘ Njoftimbi vendimin e AK-se’, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ri-Tender II te ndërtimi i Qendrës se Biznesit faza II” me numër të prokurimit 632-25-5966-5-2-1.

### ***-Përfundim –***

Paneli shqyrtues ka vendosur të pranojë vendimin e AK-së ashtu sikur u cekë më lartë. Ky vendim është nxjerrë nga një komision i vlerësimit brenda AK-së, i cili supozohet të jetë profesional dhe të ketë përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës, bazuar në nenin 59 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Përveç kësaj, paneli shqyrtues thekson se, në përputhje me nenin 8 dhe 9 të LPP-së, çdo autoritet kontraktues, siç është AK në këtë rast, gëzon autonomi për të planifikuar dhe përcaktuar nevojat e prokurimit në përputhje me kapacitetin buxhetor. Bazuar edhe në nenin 24 paragrafi 2 të LPP-së, që i jep AK-së përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të ekzekutohen në përputhshmëri me ligjin.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.





Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Batisha Ibrahim**

**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - "TRIANGLE" SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: